



Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve
Animal Rights Foundation
Fondacija za prava životinja

RAPORT PËR VLERËSIMIN E DINAMIKËS SË POPULLSISË SË **QENVE** NË KOMUNËN E **PRISHTINËS**



PRISHTINË, MAJ 2023



BOTUES	→	Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve
AUTORËT	→	Elza Ramadani, Arif Aliu
RISHIKUAR NGA	→	Dr. Driton Çausi dhe Dr. Bardhyl Noci
PËRPUNIMI I TË DHËNAVE	→	MSc. Berat Abdiu
DIZAJNI	→	M.A Donika Rexhepi (Berlin)
<p>► Mbledhja e të dhënave në terren u krye nga ekipet e OJQ 'Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve'.</p>		

► Versionin elektronik të raportit e gjeni në www.animalrights-rks.org

► **Publikimi i dytë i raportit**

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia, dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e Fondacionit për të Drejtat e Kafshëve dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së, Suedisë apo Luksemburgut.

► WWW.ANIMALRIGHTS-RKS.ORG

RAPORT PËR VLERËSIMIN E DINAMIKËS SË POPULLSISË SË **QENVE** NË KOMUNËN E **PRISHTINËS**

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve (Për Kafshët).

Ligji Nr. 04/L-065 Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta mbron të drejtat dhe pronën intelektuale. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve pa lejen paraprake me shkrim nga FDK.

► Për informata shtesë ju lutemi të kontaktoni:
info@animalrights-rks.org ose **+383 49 444 237**.

Të dhënat dhe perceptimet e paraqitura në këtë raport nuk janë vlerësim përfundimtar i punës së institucioneve në lidhje me situatën me qentë endacak. Raporti do t'u shërbejë si instrument për të adresuar problemet me prioritet, por edhe si tregues i efektivitetit të masave të ndërmarra deri më tani për menaxhimin dhe kontrollin e popullsisë së **qenve (endacak)**.

PERMBAI

SHKURTESAT	5
I. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME	6
II. HYRJE	8
III. METODOLOGJIA	10
A. Numërimi i qenve në rrugë dhe vlerësimi i mirëqenies së tyre	11
B. Anketimi i amvisërive për dinamikën e qenve	13
IV. TË GJETURAT DHE TË DHËNAT	
1. Rezultatet e numërimit sipas zonave	16
1.1 Zonat neutrale	
1.2. Zonat e njohura me prezencë të madhe të qenve (hotspot)	18
2. Rezultatet e anketimit të amvisërive	24
2.1. Mbajtja e qenve dhe statusi i tyre i riprodhimit	24
Graf. 2. Mbajtja e qenve në amvisëri	24
Graf. 3. Statusi i riprodhimit të qenve me mbajtës/pronar	24
Graf. 4. Gjinia e qenve me mbajtës/pronar	25
Graf. 5. Arsyet e mos kastrimit/sterilizimit	25
Graf. 6. Mënyra e mbajtjes së qenve	26
Graf. 7. Mbajtja e qenve në shtëpi sipas zonave urbane dhe rurale	26

LEDHJA

Graf. 8. Kohëzgjatja e qenve të lidhur me zinxhir	27
Graf. 9. Kufizimi i qenve brenda ambienteve të shtëpisë	27
Graf. 10. Kufizimi i qenve të pa kastruar/sterilizuar me pronar	28
Graf. 11. Lindja e këlyshëve nga qentë me pronar në 12 muajt e fundit	28
Graf. 12. Braktisja e këlyshëve	29
2.2. Kujdesi për qentë në rrugë	29
Graf. 13. Kujdesi nga qytetarët për qentë në rrugë	30
Graf. 14. Lloji i kujdesit për qentë në rrugë	30
2.3. Shqetësimet nga qentë në rrugë dhe keqtrajtimi apo frikësimi i tyre	31
Graf. 15. Shqetësimet nga qentë në rrugë	31
Graf. 16. Llojet e shqetësimeve nga qentë në rrugë	31
Graf. 17. Numri i qenve endacak sipas respondentëve	32
Graf. 18. Qentë që shkaktojnë probleme në komunitet	32
Graf. 19. Keqtrajtimi apo ngacmimi i qenve endacak nga qytetarët	33
2.4. Zgjidhja për qentë në rrugë sipas qytetarëve	33
Graf. 20. Zgjidhja për qentë në rrugë sipas respondentëve	34
Graf. 21. Interesimi për adoptim	34

V.

KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET	35
-------------------------------------	----



WOOF
WOOF
WOOF

SHKURTESAT:

AUV	→	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
FDK	→	Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve
ICAM	→	International Companion Animal Management Coalition
KSVL	→	Kap, sterilizo, vaksino, lësho
MAPL	→	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MPQ	→	Menaxhimi i Popullsisë së Qenve
UA	→	Udhëzim Administrativ
WOAH	→	World Organization for Animal Health

PËRMBLEDHJE E PËRGGJITHSHME

Projekti **"Vlerësimi i dinamikës së popullsisë së qenve"** është projekti i parë i këtij lloji në Kosovë, i zbatuar nga organizata **"Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve"**, pas pjesëmarrjes në trajnimin e organizuar nga RAWC¹ në korrik 2022, për udhëzuesin e vlerësimit të ndërhyrjeve në MPQ të krijuar nga ICAM. Pas përfundimit të këtij trajnimi, FDK ka zbatuar pilot-projektin e numërimit të qenve në rrugë dhe të vlerësimit të mirëqenies së tyre gjatë muajit korrik dhe gusht 2022.

Udhëzuesi i ICAM ofron rekomandime të detajuara për metodat e sakta, të besueshme dhe të realizueshme të vlerësimit të ndërhyrjeve në MPQ për të gjurmuar progresin dhe për të përmirësuar ndërhyrjet në rast nevojë. Ky udhëzues fokusohet në metoda të thjeshta dhe të përsëritshme dhe indikatorë kuptimplotë për entitetet që kërkojnë të bëjnë vlerësimin e ndikimit në MPQ me kosto efektive.

Procesi i vlerësimit dhe analizës fillestare të dinamikës së popullsisë së qenve eksploron dhe identifikon shkaqet rrënjësore të problemeve të dukshme në një lokacion specifik, duke përfshirë burimet e qenve që shkaktojnë ose përjetojnë këto probleme.

Ky raport paraqet të gjeturat e numërimit të qenve në rrugë në territorin e **Komunës së Prishtinës**, numrin e përafërt të tyre dhe statusin e mirëqenies dhe riprodhimit. Këto të dhëna janë mbledhur përmes dy periudhave kohore: **tetor/nëntor 2022** dhe **Mars 2023**. Në fazën e parë, të gjeturat e anketimit tregojnë që përqindja e sterilizimit të qenve në rrugë është **59.3%**, kurse gjatë anketimit të dytë në Mars 2023, shkalla e kastrimit/sterilizimit të qenve të identifikuar në rrugë ishte **58.61%**, që janë ende përqindje të ulëta për të stabilizuar numrin e qenve në rrugë.²



¹ www.rawc.eu

² <https://www.icam-coalition.org/download/humane-dog-population-management-guidance/>

Ky projekt po ashtu pasqyron kushtet dhe mënyrat e mbajtjes së qenve në amvisëri si burim i shtimit të numrit të qenve në rrugë. Nga të dhënat e mbledhura, një numër i madh i qenve me pronar nuk janë të sterilizuar dhe lejohen të bredhin lirshëm jashtë ambienteve të shtëpisë, duke rritur mundësinë për riprodhim me qentë në rrugë që nuk janë të sterilizuar, duke shtuar kështu edhe më shumë numrin e tyre në rrugë.

Ky projekt është fokusuar edhe tek përfshirja e qytetarëve si pjesë e zgjidhjeve për reduktimin e qenve në rrugë, prandaj është marrë edhe mendimi i qytetarëve për zgjidhjet potenciale për qentë e rrugës, përkujdesjen ndaj qenve të rrugës dhe shqetësimet nga prezenca e qenve në rrugë, si dhe interesimi për adoptimin e këtyre qenve. Nga të gjeturat e anketimit, qytetarët e Prishtinës kanë treguar preferenca për reduktimin e numrit të qenve në rrugë përmes metodave humane, e jo përmes **metodave si vrasja e qenve**.

Ky raport përmban rekomandime konkrete të bazuara nga të dhënat në terren, për dizajnimin dhe zbatimin e masave të qëndrueshme për MPQ në Komunën e Prishtinës, por që këto rekomandime vlejné edhe për institucionet e nivelit qendror që janë të mandatuara për dizajnimin e masave për MPQ.

Dizajnimi i programeve lokale të MPQ, vlerësimi paraprak i kësaj popullsie në Kosovë, si dhe monitorimi dhe vlerësimi i ndërhyrjeve për MPQ-të në nivel komunal, janë pjesë kyçe të **'Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin dhe Kontrollin e Qenve me dhe pa Pronar'**,³ e draftuar nga grupi punues ndër-institucional i udhëhequr nga MAPL, pjesë e të cilit ishte edhe FDK. *Strategjia është aprovuar më 26 Tetor 2022 nga Qeveria e Republikës së Kosovës.*

Në mënyrë që të reduktohet numri i qenve në nivel vendi, FDK rekomandon (duke u bazuar po ashtu në Strategjinë Kombëtare të lartshënuar) që *secila komunë të bëjë vlerësimin fillestar të popullsisë së qenve në territorin e tyre dhe të dizajnojë masa të përshtatura me të dhënat e mbledhura nga terreni, pasi që është tejet e rëndësishme që **popullsia e qenve të kontrollohet dhe menaxhohet** nga të gjitha komunat paralelisht. Vetëm një ose disa komuna nuk mund ta reduktojnë numrin e qenve në rrugë në mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjate.*



³<https://mapl.rks-gov.net/news/ne-mbledhjen-e-102-te-te-qeverise-se-republikes-se-kosoves-miratohet-draft-strategjia-kombetare-per-menaxhimin-dhe-kontrollin-e-qenve-me-dhe-pa-pronar-per-periudhen-2022-2023/>



HYRJE

Tashmë disa vite **situata me numrin e madh të qenve në rrugë po shkakton probleme për njerëzit dhe vet mirëqenien e qenve në rrugë**, prandaj është e rëndësishme që institucionet (lokale dhe qendrore) të ndërmarrin masa efektive dhe humane për zgjidhje të qëndrueshme të kësaj situate, duke u nisur nga të dhëna shkencore dhe statistikore për situatën aktuale me popullsinë e qenve në vendin tonë. Vlerësimi profesional fillestar i situatës në terren është thelbësor dhe do të ndihmojë në hartimin e programeve të suksesshme lokale të menaxhimit të popullsisë së qenve.

Gjendja aktuale me numrin e madh të qenve endacak në Kryeqytet (por edhe në komunat e tjera) është temë mjaft e përfolur nga qytetarët dhe së fundmi është temë e diskutuar po ashtu nga institucionet e mandatuara për zgjidhjen e këtij problemi, qoftë të nivelit qendror apo atij lokal dhe kjo falë punës së palodhshme të FDK.

Organizata **“Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve”** punon që nga viti 2018 në monitorimin dhe vlerësimin e projekteve të nivelit qendror dhe lokal sa i përket trajtimit të qenve endacak me qëllim të reduktimit të numrit të tyre në rrugë, dhe për fat të keq asnjë nga projektet/kontratat publike (më shumë se 68 projekte nga viti 2008-2021) nuk janë projektuar dhe zbatuar me një vlerësim fillestar të numrit të qenve në rrugë, dhe as me monitorim të mirëfilltë nga ana shtetërore apo komunale gjatë zbatimit të projekteve në fjalë. Për më tepër, nuk ka pasur as vlerësim të masave pas përfundimit të intervenimeve për të matur efektivitetin e tyre për reduktimin e numrit të qenve endacak.

Prandaj, me këtë projekt, FDK ka synuar mbledhjen e të dhënave relevante për dinamikën dhe numrin e qenve në Komunën e Prishtinës, për të mbështetur komunën në dizajnimin dhe zbatimin e masave të qëndrueshme për reduktimin e numrit të qenve në rrugë. Në planin strategjik të komunës së Prishtinës për MPQ,⁴ përveç KSVL-së është paraparë edhe zbatimi i masave tjera, siç janë: **regjistrimi i qenve endacak me mikroçip, ndërtimi i qendrës për trajtim të përkohshëm për kafshët endacake⁵ dhe pikat ushqyese për kafshët në rrugë për të evituar incidentet për shkak të urisë së kafshëve dhe për t’u kujdesur për mirëqenien e qenve në rrugë.**

Një masë shtesë, siç është **Identifikimi & Regjistrimi i qenve me mbajtës/pronar**, e cila është obligim i nivelit komunal, është duke u zbatuar dhe ofruar falas nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, për të gjithë pronarët e qenve në tridhjetë (30) komuna të Kosovës.⁶

⁴ <https://telegrafi.com/qente-endacake-komuna-e-prishtines-dhjetefish-shume-buxhet-per-trajtimin-e-tyre/>

⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=15166>

⁶ <https://auvk.rks-gov.net/njoftim-7/>

Identifikimi & Regjistrimi i qenve me mbajtës është masë thelbësore për të kontrolluar popullsinë e qenve në përgjithësi dhe sidomos për të parandaluar braktisjen e qenve në rrugë nga pronarë të shumtë.

Pas konsultimeve mes FDK dhe Komunës, komuna e Prishtinës ka themeluar grupin punues ndër-institucional komunal për menaxhimin e situatës me qentë endacak, ashtu siç rekomandohet nga organizata ICAM⁷ dhe nga shumë organizata të huaja me përvojë shumëvjeçare në MPQ.⁸ FDK si pjesë e këtij grupi punues ka kontribuar në këshillimin e Komunës qysh nga fillimi për ndërmarrjen e masave të qëndrueshme që bazohen në të dhëna faktike dhe praktika të sukseshme nga vendet tjera.

Përmes të dhënave të mbledhura nga projekti i **"Vlerësimi i dinamikës së popullsisë së qenve"**, FDK synon të mbështesë institucionet përgjegjëse për të zbatuar dispozitat ligjore në fuqi, për të krijuar një qasje sistematike dhe serioze institucionale për një *menaxhim të qëndrueshëm të popullsisë së qenve (endacak)* në Prishtinë, duke krijuar një program të mirëfilltë lokal për MPQ, i cili do të sigurojë përdorimin më efektiv të burimeve komunale duke u fokusuar në çështjet më urgjente që lidhen me dinamikën e popullsisë së qenve.

Çdo masë apo ndërhyrje për menaxhimin dhe kontrollin e popullsisë së qenve duhet të jetë e bazuar në të dhëna reale nga terreni. Monitorimi dhe vlerësimi i këtyre ndërhyrjeve është po ashtu shumë i rëndësishëm për t'u siguruar efektiviteti dhe ndikimi i duhur i masave të ndërmarra.

Megjithëse nuk ka një standard zyrtar ndërkombëtar për vlerësimin fillestar të dinamikës së popullsisë së qenve dhe matjen e ndërhyrjeve për MPQ, ICAM ka përpiluar një udhëzues të dedikuar⁹ për institucionet publike dhe OJQ-të, për monitorimin dhe vlerësimin e ndërhyrjeve për kontrollin dhe menaxhimin e popullsisë së qenve.

⁷ Koalicioni Ndërkombëtar i Menaxhimit të Kafshëve Shoqëruese (ICAM) u formua në vitin 2006 për të mbështetur zhvillimin dhe përdorimin e menaxhimit njerëzor dhe efektiv të popullsisë së kafshëve shoqëruese në mbarë botën dhe përbëhet nga organizata botërore si RSPCA, FOUR PAWS, WORLD ANIMAL PROTECTION, WSAVA, INTERNATIONAL CAT CARE, DOGSTRUST, BATTERSEA.

⁸ <https://prishtinaonline.com/lajmet/3557/themelohet-grupi-punues-ne-bashkepunim-edhe-me-aktore-jashte-strukture-komunale-per-trajtimin-e-qenve-endacake-ne-kryeqytet>

⁹ <https://www.icam-coalition.org/download/are-we-making-a-difference/>

IDENTIFIKIMI DHE REGJISTRIMI I QENEVE ME MIKROÇIP





METODOLOGJIA

Sipas ICAM, për të arritur deri tek menaxhimi i suksesshëm i popullsisë së qenve, ndikimet (objektivat) më të rëndësishme që duhet arritur nepërmjet masave të ndërmarra, janë si mëposhtë:

- | | |
|----------|---|
| 1 | → Përmirësimi i mirëqenies së qenve |
| 2 | → Përmirësimi i kujdesit të ofruar për qentë |
| 3 | → Zvogëlimi i densitetit të qenve (numrit të tyre) |
| 4 | → Zvogëlimi i rrezikut për shëndetin dhe sigurinë publike |
| 5 | → Përmirësimi i performancës së qendrave të ristrehimit |
| 6 | → Zvogëlimi i ndikimeve negative të qenve në kafshë të egra |
| 7 | → Zvogëlimi i ndikimeve negative të qenve në kafshë shtëpiake |

Për secilën nga këto ndikime, *propozohet më shumë se një indikator* për të vlerësuar efektivitetin e masave të ndërmarra (projekteve publike apo private).

Për qëllime të këtij projekti, fokusi është drejtuar tek **ndikimet 1- 4**, për të cilat janë përdorur *indikatorët* si më poshtë:

- In1.** Vlerësimi i gjendjes së trupit të qenve në rrugë
- In2.** Vlerësimi i gjendjes së lëkurës së qenve në rrugë
- In3.** Proporcioni meshkuj – femra tek qentë e rrugës
- In4.** Përkudësja e njerëzve për qentë e rrugës
- In5.** Densiteti i qenve në rrugë
- In6.** Numri i qenve femra në laktacion
- In7.** Numri i këlyshëve
- In8.** Statusi i riprodhimit
- In9.** Numri i incidenteve me qentë në rrugë
- In10.** Numri i qenve të vaksinuar kundër tërbimit
- In11.** Adoptimi i qenve
- In12.** Sjelljet me qentë e rrugës
- In13.** Shqetësimet në lidhje me qentë e rrugës
- In14.** Keqtrajtimi dhe braktisja e qenve

Matja e dinamikës së qenve në rrugë është bërë me anë të këtyre indikatorëve dhe përmes aktiviteteve si më poshtë:

- A. Numërimi i qenve në rrugë dhe vlerësimi i mirëqenies së tyre**
- B. Anketimi i amvisërive për dinamikën e popullsisë së qenve**

A.

Numërimi i qenve në rrugë dhe vlerësimi i mirëqenies së tyre

Numërimi i qenve në rrugë është një metodë efikase për mbledhjen e të dhënave bazuar në një sërë indikatorësh, për të vlerësuar mirëqenien e qenve në rrugë si dhe densitetin (numrin) e tyre. Efikasiteti i kësaj metode e bën këtë metodë të përshtatshme për monitorim dhe vlerësim, sepse mund të përsëritet disa herë gjatë një ndërhyrjeje në MPQ.

Numërimi i qenve në rrugë ndahet në dy komponentë. **Komponenti i parë** përfshin *rrugët e zgjedhura në mënyrë të rëndomtë, apo zonat neutrale (ang. unbiased routes)*, kurse **i dyti** përfshin *zonat e njohura me prezencë të madhe të qenve (ang. hotspot routes)*.

Zonat neutrale tregojnë për numrin e përafërt të qenve në rrugë duke anketuar së paku **20 km të rrugëve në katër (4) pjesët e qytetit: jug, veri, lindje dhe perëndim** - për të nxjerrë mesataren e numrit të qenve sipas kalkulimeve të rekomanduara nga ICAM. Zonat **'hotspot'** tregojnë gjendjen riprodhuese të qenve dhe masin indikatorët e mëposhtëm:

- ▶ Gjendja e trupit të qenve
- ▶ Gjendja e lëkurës së qenve
- ▶ Proporcioni meshkuj – femra tek qentë
- ▶ Densiteti i qenve në rrugë
- ▶ Numri i qenve femra në laktacion
- ▶ Numri i këlyshëve
- ▶ Statusi i riprodhimit
- ▶ Numri i qenve të vaksinuar kundër tërbimit

Ekipet e anketimit kanë qenë të përbëra nga të paktën tre (3) persona. Të gjithë anëtarët e ekipeve të anketimit kanë qenë përgjegjës për të vërejtur qentë në rrugë kurse një person ka futur të dhënat e gjetura në aplikacionin e dedikuar për numërim të qenve. Ekipet kanë ndjekur rrugën e paracaktuar, duke u ndalur për të regjistruar çdo qen të dukshëm në hapësirë publike, para se të lëviznin sa më shpejt që ishte e mundur; mbajtja e një ritmi konstant është e rëndësishme për të shmangur numërimin e dyfishtë dhe për të mbuluar rrugën me efikasitet.

Për të vlerësuar gjendjen e trupit të qenit, sa i përket peshës, janë përdorur rekomandimet e ICAM për indeksin (nga 1-5) e gjendjes së trupit.¹⁰

¹⁰ <https://www.icam-coalition.org/tool/dog-body-condition-scoring-training/>

Për hulumtimin e qenve të dukshëm në rrugë, çdo qen ndahet në një nga **shtatë (7) kategoritë: mashkull, mashkull i kastruar, femër, femër e sterilizuar, femër gjdhënëse, këlysh (nën 4 muaj), i rritur me gjini të panjohur**. Çdo qen është vlerësuar gjithashtu për statusin e mirëqenies (*vlerësimi i peshës së trupit dhe prezenca e sëmundjeve të dukshme të lëkurës*) dhe potencialisht nëse ka një qafore (*mbajtës/familje*).

Meqenëse në Kosovë **qentë e trajtuar me metodën KSVL identifikohen me vath në vesh**, për qëllime të këtij projekti, *prezenca apo mungesa e vathit në vesh ka shërbyer si indikator i statusit të riprodhimit të qenit dhe të vaksinimit kundër tërbimit*.

Në rastet kur atributet si gjinia, statusi i riprodhimit dhe statusi i mirëqenies, nuk është mundur të vlerësohen me saktësi për shkak se qeni ishte në distancë të largët nga ekipi, qentë janë kategorizuar si të panjohur sa i përket gjinisë, statusit të riprodhimit dhe mirëqenies.



Aplikacionet e përdorura për **Aktivitetin A**

Për t'i përcaktuar zonat neutrale/objektive, është përdorur platforma online **TrailRouter**¹¹ e cila gjeneron automatikisht rrugët, në mënyrë që **katër (4)** zonat neutrale të mos jenë në asnjë mënyrë subjektive në raport me prezencën e qenve.

Për përcaktimin e rrugëve për zonat e njohura me prezencë të madhe të qenve, është përdorur **Google My Maps**.¹²

Për krijimin e shabllonëve të anketimit të rrugëve të paracaktuara, për navigimin në rrugë, si dhe për numërimin e qenve, është përdorur aplikacioni mobil **Talea**¹³, që është aplikacion i zhvilluar nga ICAM, pikërisht për qëllime të mbledhjes së të dhënave për qentë në rrugë.

¹¹ <https://www.trailrouter.com>

¹² <https://mymaps.google.com>

¹³ <https://www.icam-coalition.org/tool/talea-street-survey-app/>

B.

Anketimi i amvisërive për dinamikën e qenve

Anketimi i amvisërive përmes pyetësorit shërben për matjen e një brezi të gjerë indikatorësh:

- ▶ Përkudesja e njerëzve për qentë në rrugë
- ▶ Incidentet me qentë në rrugë
- ▶ Adoptimi i qenve
- ▶ Sjelljet me qentë e rrugës
- ▶ Shqetësimet në lidhje me qentë e rrugës
- ▶ Keqtrajtimi dhe braktisja e qenve
- ▶ Mbajtja e qenve nëpër amvisëri

Aktiviteti i anketimit të qytetarëve përmes pyetësorit në amvisëri ka paraparë intervistimin e 623 respondentëve (amvisërive) me intervista efektive. Përkatësisht, numri i respondentëve të anketuar është përcaktuar për të kuptuar më mirë gjendjen dhe tendencën për mbajtje të qenve, braktisjen e tyre dhe kujdesit ndaj qenve në rrugë apo shqetësimet nga ta.

Anketimi me qytetarë (amvisëritë) është kryer duke bërë pyetje mbi gjendjen e qenve endacak në lagjen e tyre, të kuptohet sa familje lejojnë qentë e tyre të bredhin lirshëm dhe pyetje të tjera në interes të vlerësimit të dinamikës së qenve dhe vlerësimit të gjendjes sa i përket menaxhimit dhe kontrollit të qenve, nga perspektiva e komunitetit/njerëzve. Anketimi mbi mbajtjen e qenve nëpër shtëpi është i rëndësishëm për të kuptuar se sa përqind popullohen rrugët me qen me pronar por që lejohen të bredhin në rrugë; po të njëjtit duke mos qenë të kastruar/sterilizuar, riprodhohen me qentë aktual në rrugë.


Pyetësori përfshin një grup pyetjesh të standardizuara që ishin të mbyllura (pyetje me një grup të kufizuar përgjigjesh për të zgjedhur, si 'po' ose 'jo') ose në format të përgjigjeve me shumë zgjedhje, për të ndihmuar në analizën e të dhënave me të gjitha përgjigjet e mundshme të listuara, duke përfshirë një përgjigje "nuk e di" për të shmangur detyrimin e të anketuarit të hamendësojë për një përgjigje.

Grafiku më poshtë (Graf. 1) e shpalos shpërndarjen pas peshimit (korrigjimit) të mostrës, i cili është aplikuar për të korrigjuar proporcionet në mes të totaleve të anketave të marra nga vendbanimet rurale dhe ato urbane. Peshimi është zbatuar në mostrën e arritur për të pasqyruar shpërndarjen aktuale të popullsisë, në kuptimin e shtrirjes së popullsisë në mes të vendbanimeve urbane dhe rurale.

Përkatësisht, mostra e arritur e anketimit (para peshimit) ka një përfaqësim më të lartë të vendbanimeve rurale në raport me proporcionin e tyre në përgjithësi në nivel të komunës, dhe kjo është korrigjuar për nevojat e analizës dhe mundësisë së inferencës statistikore (gjeneralizimit) të gjetjeve nga mostra drejt popullsisë së synuar.

Duke ju referuar planit zhvillimor urban¹⁴ të komunës së Prishtinës, mostra e anketuar është peshuar për të reflektuar shpërndarjen e popullsisë në kuptimin e territorit, **92% zona urbane dhe 8% zona rurale.**

SHPËRNDARJA E MOSTRËS - EX POST PESHIMIT N=623



GRAF. 1. SHPËRNDARJA E MOSTRËS SË ANKETIMIT PAS ZBATIMIT TË PESHIMIT

Për anketimin e amvisërive dhe plotësimin e pyetësorit është përdorur aplikacioni **KoboToolbox**.¹⁵ Për krijimin e pyetësorit është përdorur shablloni i krijuar nga ICAM, i cili është përkthyer dhe përshtatur për realitetin në Kosovë dhe për qëllime të këtij projekti.

Ekipet kanë kryer anketimin përgjatë 12 ditëve, ndërsa shpërndarja e mostrës duke mbuluar fshatrat dhe lagjet e komunës së Prishtinës është paraqitur më poshtë (Tab. 1 & Fig. 1).

¹⁴https://kk.rks-gov.net/prishtine/wp-content/uploads/sites/45/2018/02/PZHU-_Prishtina.pdf

¹⁵<https://www.kobotoolbox.org/>

TAB.1. SHPËRNDARJA E MOSTRËS SË ANKETIMEVE

VENDBANIMI	NUMRI I ANKETAVE	PËRQINDJE
Mati 1	66	10.6
Qendra	59	9.5
Hajvalia	52	8.3
Bardhosh	41	6.6
Çagllavicë	35	5.6
Matiçan	32	5.1
Arbëri	30	4.8
Bregu i diellit	25	4.0
Taslixhe	25	4.0
Vranjevc	25	4.0
Emshir	24	3.9
Teneshdoll	23	3.7
Lakrishte	22	3.5
Llukar	21	3.4
Ulpianë	18	2.9
Dardani	17	2.7
Shkabaj	15	2.4
Makoc	14	2.2
Vranidoll	13	2.1
Zllatar	11	1.8
Grashticë	10	1.6
Prugoc	10	1.6
Trudë	9	1.4
Kolovicë	8	1.3
Barilevë	7	1.1
Mramor	6	1.0
Sofali	5	0.8




FIG 1. HARTA E MBULIMIT TË ANKETIMIT TË AMVISËRIVE NË KOMUNËN E PRISHTINËS


IV.

TË GJETURAT DHE TË DHËNAT

1. Rezultatet e numërimit sipas zonave

1.1. Zonat neutrale

1.1.1 PERIUDHA E PARË: **TETOR/NËNTOR 2022**



Numri i përafërt i qenve në territorin e komunës së **Prishtinës** për periudhën *Tetor/Nëntor 2022*: **2926**.

Mesatarja e qenve për kilometër (km) në rrugët e anketuara ishte: **2.36**. Numri i përafërt i qenve të dukshëm në **orët e hershme të mëngjesit** ishte: **1170** dhe indeksi i dukshmërisë së qenve është kalkuluar me vlerën 0.4 sipas rekomandimeve të ICAM.¹⁶

Në total, në Komunën e Prishtinës, proporcioni i gjinisë së qenve ishte 35.4% meshkuj dhe 20.9% femra. Nga popullsia e qenve në rrugë, **59%** të qenve me gjini të dukshme ishin të *sterilizuar/kastruar*. Nga numri total i qenve të numëruar, **43.7%** e qenve *nuk kanë mundur të identifikohen* sa i përket gjinisë dhe statusit të riprodhimit apo gjendjes së trupit. Nga numri total i qenve të identifikuar të gjinisë mashkullore, **70.6%** ishin të *kastruar*, kurse nga numri total i qenve të identifikuar të gjinisë femërore, **40%** ishin të *sterilizuara*. Nga totali i qenve të gjinisë femërore të identifikuar, vetëm **10%** ishin në *laktacion*¹⁷ dhe *asnjë këlysh* nuk është parë në rrugë gjatë anketimit të zonave neutrale.

¹⁶ Ne përdorëm vlerësimin prej 0.4, sepse nuk ka një vlerësim tjetër për një zonë urbane në Evropën Lindore. ICAM zbuloi se kjo shifër ishte më afër 0.3 në një studim në Serbi, por kjo ishte në një zonë rurale, ku kishte mundësi të ndryshme për qentë për t'u fshehur në krahasim me mjedisin e qytetit. Nëse marrim një vlerësim të zbulueshmërisë në Prishtinë (p.sh. duke përdorur një studim të shenjzimit dhe ri-identifikimit të qenve në rrugë - (ang. mark-resight study), ose në një qytet të ngjashëm, duhet të ndryshojmë logaritjet, deri atëherë mendojmë se 0.4 është më e mira që kemi.

¹⁷ Qentë e gjinisë femërore gjdhënëse

Zona me mbulueshmëri më të madhe të kastrimit/sterilizimit ishte **pjesa perëndimore** e qytetit me **71.4%** (fig. 2), kurse **pjesa jugore** (fig. 3) nuk kishte fare mbulueshmëri sa i përket kastrimit dhe sterilizimit të qenve.

Nga totali i qenve të identifikuar, **94%** të qenve kishin gjendje ideale të trupit (*indeksi 3 i gjendjes së trupit*), kurse **87.5%** të qenve nuk kishin probleme të dukshme të lëkurës.

Marrë parasysh të dhënat e mësipërme, mund të konstatohet që **91%** e qenve të identifikuar në Prishtinë në bazë të pamjes së jashtme, janë në gjendje të mirë shëndetësore.



Gjatë anketimit të rrugëve neutrale, ekipet anketuese nuk kanë hasur në asnjë qen me sjellje agresive.



FIG. 2. ANKETIMI NË ZONËN NEUTRALE NË PJSËN PERËNDIMORE TË PRISHTINËS



FIG. 3. ANKETIMI NË ZONËN NEUTRALE NË PJSËN JUGORE TË PRISHTINËS



FIG. 4. ANKETIMI NË ZONËN NEUTRALE NË PJSËN LINDORE TË PRISHTINËS





FIG. 5. ANKETIMI NË ZONËN NEUTRALE NË PJSËN VERIORE TË PRISHTINËS



Numri mesatar i qenve në territorin e komunës së Prishtinës **për periudhën e dytë në 2023**, ishte: **3772**.

Mesatarja e qenve për kilometër (km) në rrugët e anketuara: **3**. Numri i përafërt i qenve të dukshëm në orët e hershme të mëngjesit: **1509**.

Në Komunën e Prishtinës, proporcioni i gjinisë së qenve ishte 34.42% meshkuj dhe 32.79% femra. Nga popullsia e qenve në rrugë, **58.6%** të qenve me gjini të dukshme ishin të sterilizuar/kastruar, kurse **27.8%** e qenve nuk kanë mundur të identifikohen sa i përket gjinisë dhe statusit të riprodhimit apo gjendjes së trupit. Nga numri total i qenve të identifikuar të gjinisë mashkullore, **66.67%** ishin të kastruar, kurse nga numri total i qenve të identifikuar të gjinisë femërore, **55%** ishin të sterilizuara. Nga totali i qenve të gjinisë femërore të identifikuara, **10%** ishin në laktacion¹⁸ dhe **4.9%** ishin këlyshë.

Zona me mbulueshmërinë më të madhe të kastrimit/sterilizimit ishte pjesa veriore e qytetit me **73.3%**, kurse pjesa perëndimore kishte mbulueshmërinë më të vogël sa i përket kastrimit dhe sterilizimit të qenve, me **50%**.

Nga totali i qenve të identifikuar, **88.5%** të qenve kishin gjendje ideale të trupit (indeksi 3 i gjendjes së trupit) dhe nuk kishin probleme të dukshme të lëkurës.

¹⁸ Qentë e gjinisë femërore gjidhënëse

Zona me mbulueshmërinë më të madhe të *kastrimit/sterilizimit* ishte pjesa veriore e qytetit me **73.3%**, kurse pjesa perëndimore kishte mbulueshmërinë më të vogël sa i përket kastrimit dhe serilizimit të qenve, me **50%**.

Nga totali i qenve të identifikuar, **88.5%** të qenve kishin gjendje ideale të trupit (indeksi 3 i gjendjes së trupit) dhe nuk kishin probleme të dukshme të lëkurës.




FIG .6. ANKETIMI NË ZONËN NEUTRALE NË PJESËN PERËNDIMORE TË PRISHTINËS




FIG .7 ANKETIMI NË ZONËN NEUTRALE NË PJESËN JUGORE TË PRISHTINËS



FIG .8. ANKETIMI NË ZONËN NEUTRALE NË PJESËN LINDORE TË PRISHTINËS




FIG .9. ANKETIMI NË ZONËN NEUTRALE NË PJESËN VERIORE TË PRISHTINËS

1.2. Zonat e njohura me prezencë të madhe të qenve (HOTSPOT)

1.2.1 PERIUDHA E PARË: TETOR/NËNTOR 2022

Zonat "hotspot" janë zona të qytetit të cilat janë të njohura për prezencë të madhe të qenve. Këto zona anketoohen për të parë gjendjen e riprodhimit të qenve, mirëqenien e tyre, sa nga qentë e gjinisë femërore janë në laktacion apo në total të pasqyrohet gjendja me këlyshët në rrugë. Zonat "hotspot" tregojnë në total për gjendjen e gjetur por po ashtu tregojnë qartë për secilën pjesë të anketuar se si është gjendja e qenve dhe cilat masa për menaxhimin e popullsisë së qenve ende mungojnë në ato pjesë me prezencë të madhe të qenve.

Gjatë hulumtimit të zonave "hotspot" janë regjistruar në total **78 qen** në periudhën e parë.



Nga numri total i qenve të numëruar, **41%** e qenve nuk kanë mundur të identifikohen sa i përket gjinisë dhe statusit të riprodhimit apo gjendjes së trupit, kurse nga totali i qenve gjinia e të cilëve ka mundur të identifikohet, **59%** ishin të sterilizuar/kastruar.

Nga numri total i qenve të identifikuar të **gjinisë mashkullore** në të gjitha zonat e anketuara "hotspot", **60%** ishin të kastruar. Nga numri total i qenve të identifikuar të **gjinisë femërore** në të gjitha zonat e anketuara "hotspot", **57%** ishin të sterilizuar dhe **14%** ishin në laktacion, kurse nga totali i qenve të regjistruar, **9%** ishin këlyshë.

Zona "hotspot" me mbulueshmërinë më të madhe të kastrimit/sterilizimit ishte qendra e qytetit me **79%** (fig. 6). Zona "hotspot" në Breg të Diellit kishte **57%** (fig. 7) të qenve të kastruar/sterilizuar, kurse zona "hotspot" në Parkun e Gërmisë kishte të mbuluar me kastrim/sterilizim vetëm 50% të qenve (fig. 8). Zona "hotspot" në rrugën "B" dhe "C" kishte mbulueshmërinë më të vogël sa i përket kastrimit dhe sterilizimit të qenve, vetëm me **14%** (fig. 9).

Nga totali i qenve të identifikuar, **78%** e qenve kishin **gjendje ideale të trupit** (indeksi 3 i gjendjes së trupit), kurse **90%** e qenve nuk kishin probleme të dukshme të lëkurës

Marrë parasysh të dhënat e mësipërme, mund të konstatohet që 84% e qenve të identifikuar në Prishtinë në rrugët e njohura me prezencë të madhe të qenve (hotspot), në bazë të pamjes së jashtme, janë në gjendje të mirë shëndetësore.



As gjatë anketimit të rrugëve me prezencë të madhe të qenve, ekipet anketuese nuk kanë hasur në asnjë qen me sjellje agresive.



FIG.10. ZONA ME PREZENCË TË MADHE TË QENVE - QENDRA E QYTETIT




FIG. 11. ZONA ME PREZENCË TË MADHE TË QENVE - BREGU I DIELLIT



FIG.12. ZONA ME PREZENCË TË MADHE TË QENVE - PARKU I GËRMISË



FIG.13. ZONA ME PREZENCË TË MADHE TË QENVE - RRUGA B DHE C

1.2.2. PERIUDHA E DYTË: MARS 2023

Gjatë hulumtimit të zonave "hotspot" janë regjistruar në total **88 qen** gjatë *periudhës së dytë*.

Nga numri total i qenve të numëruar, **23.87%** e qenve nuk kanë mundur të identifikohen sa i përket gjinisë dhe statusit të riprodhimit apo gjendjes së trupit. Nga totali i qenve gjinia e të cilëve ka mundur të identifikohet, **72%** ishin të *sterilizuar/kastruar*.

Nga numri total i qenve të identifikuar të gjinisë mashkullore në të gjitha zonat e anketuara "hotspot", **65%** ishin të *kastruar*. Nga numri total i qenve të identifikuar të gjinisë femërore në të gjitha zonat e anketuara "hotspot", **87.9% ishin të sterilizuar** dhe **1% ishin në laktacion** kurse nga totali i qenve të regjistruar, **4.5% ishin këlyshë**.

Zonat "hotspot" me mbulueshmërinë më të madhe të **kastrimit/sterilizimit** ishin qendra e qytetit dhe Bregu i Diellit me **89%**, kurse zona "hotspot" në rrugën "B" dhe "C" kishte mbulueshmërinë më të vogël sa i përket *kastrimit* dhe *sterilizimit* të qenve, me vetëm **50%** por kishte rritje nga periudha e parë ku mbulueshmëria e *sterilizimit/kastrimit* ishte vetëm **14%**. Zona "hotspot" në parkun e Gërmisë, kishte **60%** mbulueshmëri të *kastrimit/sterilizimit*, **10%** më shumë se në periudhën *tetor/nëntor 2022*.



Në të gjitha zonat hotspot në muajin Mars 2023, kishte rritje të dukshme të mbulueshmërisë së kastrimit/sterilizimit.

Nga totali i qenve të identifikuar, **83%** e qenve kishin **gjendje ideale të trupit** (indeksi 3 i gjendjes së trupit), kurse **75%** e qenve nuk kishin probleme të dukshme të lëkurës.



FIG .14. ZONA ME PREZENCË TË MADHE TË QENVE - QENDRA E QYTETIT



FIG .15. ZONA ME PREZENCË TË MADHE TË QENVE - BREGU I DIELLIT



FIG .16, ZONA ME PREZENCË TË MADHE TË QENVE - PARKU I GËRMISË





FIG .17. ZONA ME PREZENCË TË MADHE TË QENVE - RRUGA B DHE C

2. Rezultatet e anketimit të amvisërive

2.1. Mbjajtja e qenve dhe statusi i tyre i riprodhimit


Nga të dhënat e mbledhura nga pyetësorët e anketimit të amvisërive, shfaqet një pasqyrë e qartë e burimit të shtimit të numrit të qenve në rrugë nga braktisja, si dhe shpërfaqet edhe shkalla e kujdesit të qytetarëve për qentë në rrugë, por edhe keqtrajtimi dhe shqetësimi i qenve nga vet qytetarët, si shkas potencial i sjelljeve jo miqësore apo agresive të disa qenve ndaj njerëzve.

Nga rezultatet e anketimit, mbajtja e qenve ende është një fenomen jo shumë i përhapur në komunën e Prishtinës, me vetëm **12%** të respondentëve të anketuar që kanë deklaruar që mbajnë qen në shtëpi (Graf.2).




GRAF.2. MBAJTJA E QENVE NË AMVISËRI

Nga të dhënat e mbledhura nga pronarët e qenve që janë përgjigjur në anketim, **54% e qenve janë të pakastruar** sa i përket statusit të riprodhimit (Graf.3).



GRAF.3. STERILIZIMI I QENVE ME PRONAR


Nga totali i qenve me pronar, **70%** janë qen të **gjinisë mashkullore**, kurse **30%** janë qen të **gjinisë femërore** (Graf.4).



GRAF.4. GJINIA E QENVE ME MBAJTËS/PRONAR


Po ashtu vlen të theksohen arsyet e dhëna nga respondentët sa i përket mos kastrimit/sterilizimit të qenve të tyre.

Në grafën më poshtë (Graf.5) shihet se **40%** e njerëzve *nuk kanë ditur rreth sterilizimit dhe kastrimit* dhe janë përgjigjur me **"nuk di për sterilizim"** por edhe opsionin "tjetër" pasi që nuk kishin arsye specifike pse nuk i kishin qentë e kastruar/sterilizuar apo edhe për ndonjë arsye personale. Më pastaj, **18%** të respondentëve mbajnë qen, kishin deklaruar se qeni i tyre *nuk ka nevojë për kastrim/sterilizim* pasi që qeni i tyre nuk bredh në rrugë. Gjithsesi është e rëndësishme të përmendet se shumë qen edhe pse qëndrojnë vetëm në oborr të shtëpisë dhe/apo janë të lidhur me zinxhir, **mund të riprodhohen me qentë tjerë** nëse oborri i shtëpisë ku mbahet qeni i pa kastruar/sterilizuar nuk është i rrethuar siç duhet për të parandaluar hyrjen e qenve tjerë. Së fundmi, **11%** të respondentëve kanë deklaruar se dëshirojnë këlyshë dhe për këtë arsye nuk dëshirojnë t'i sterilizojnë qentë e tyre, kurse **9%** ishin të bindur se qenit i ndërron karakteri apo që nuk kishte nevojë për kastrim pasi që kishin qen të gjinisë mashkullore.



GRAF. 5. ARSYET E MOS KASTRIMIT/STERILIZIMIT TË QENIT


Sa i përket kushteve të mbajtjes së qenve në amvisëritë e anketuara, **17%** e qytetarëve kanë deklaruar që qenin e tyre e mbajnë të lidhur me zinxhir, **57%** e respondentëve kanë deklaruar që qeni i tyre rrin i lirë brenda në oborr, kurse **26%** kanë deklaruar që qeni i tyre rrin brenda në shtëpi (Graf. 6).



GRAF. 6. MBAJTJA E QENVE TË LIDHUR ME ZINXHIR


Vërehet një diferencë e theksuar mes zonave urbane dhe rurale sa i përket mbajtjes së qenve të lidhur me zinxhir. Mbi **50%** të respondentëve në zona rurale kanë deklaruar që qeni tyre rrin i lidhur me zinxhir, ndërsa në zonat urbane ky numër është shumë më i vogël, me **14%** të respondentëve.

Kjo diferencë mund të vërehet edhe në situatat ku qeni rrin i lirë në shtëpi, me **28%** të respondentëve të zonave urbane që kanë deklaruar që qenin e mbajnë të lirë në shtëpi, kurse në zonat rurale kjo përqindje është më e vogël, me **10%** të respondentëve që kanë deklaruar që e mbajnë qenin brenda në shtëpi (Graf. 7).




GRAF. 7. MBAJTJA E QENVE NË SHTËPI SIPAS ZONAVE URBANE DHE RURALE

Respondentët që kanë pohuar mbajtjen e qenit të lidhur me zinxhir, po ashtu janë përgjigjur në pyetjen "sa kohë rrin qeni i lidhur me zinxhir?", dhe **42%** e tyre kanë deklaruar që mbajnë qenin të lidhur gjatë gjithë kohës (Graf. 8).




GRAF. 8. KOHËZGJATJA E MBAJTJES SË QENIT TË LIDHUR ME ZINXHIR

Sa i përket kufizimit të qenve me mbajtës/pronar (a lejohen të bredhin jashtë shtëpisë apo jo), **43%** e pronarëve kanë deklaruar që qentë nuk janë të kufizuar gjatë gjithë kohës dhe lejohen të bredhin edhe jashtë ambienteve të shtëpisë (Graf. 9).



GRAF. 9. KUFIZIMI I QENVE BREDA AMBIENTEVE TË SHTËPISË


Qentë e pa kastruar/sterilizuar që lejohen të bredhin jashtë shtëpisë, janë potencialisht burim i shtimit të numrit të qenve në rrugë, pasi që po këta qen mund të shumohen dhe riprodhohen me qentë aktual në rrugë që janë të pa kastruar/sterilizuar. Në grafën më poshtë (*Graf. 10*) vërehet se vetëm **53%** të qenve të pa kastruar/sterilizuar qëndrojnë të kufizuar gjatë gjithë kohës dhe nuk bredhin në rrugë, **kurse 47% e qenve që nuk janë të kufizuar gjithmonë në oborr mund të konsiderohen si burim i shumimit të qenve të rrugës dhe shtimit të numrit të tyre**. Qentë dhe kafshët në përgjithësi bredhin gjatë ciklit të riprodhimit, prandaj edhe nëse disa mbajtës/pronar mund të deklarohen që qentë e tyre bredhin rrugëve shumë "rrallë" apo vetëm shkurtimisht, kjo do të mjaftonte që qeni i tyre të kontribuojë në shtimin e numrit të qenve përmes shumimit me qentë e pa kastruar/sterilizuar në rrugë, edhe pa dashjen e vet mbajtësit/pronarit.




GRAF.10. KUFIZIMI I QENVE TË PA STERILIZUAR/KASTRUAR ME PRONAR

Një e dhënë tjetër e rëndësishme nga ky anketim na tregon që **35%** e qytetarëve kanë deklaruar që njohin dikë në lagjen apo fshatin e tyre, qeni i të cilit/cilës ka lindur këlyshë në 12 muajt e fundit (*Graf. 11*). Përqindja dërmuese (**79%**) e këtyre këlyshëve, sipas përgjigjeve të respondentëve, kanë përfunduar në rrugë (janë braktisur), duke shtuar kështu numrin e qenve endacak pa pronar (*Graf. 12*).

RESPONDENTËT QË KANË NJOHURI PËR LINDJEN E KËLYSHËVE
NGA QENTË ME PRONAR NË 12 MUAJT E FUNDIT



GRAF. 11. LINDJA E KËLYSHËVE NGA QENTË ME PRONAR NË 12 MUAJT E FUNDIT



GRAF.12. BRAKTISJA E KËLYSHËVE TË POSALINDUR


2.2. Kujdesi për qentë në rrugë

Një nga objektivat e këtij projekti, përveç identifikimit të burimeve të shtimit të qenve në rrugë, ishte edhe **matja e perceptimit të amvisërive për qentë** dhe toleranca që kanë qytetarët duke u përkujdesur për qentë në rrugë.


Kujdesi nga komuniteti për qentë e rrugës del të jetë në nivel të ulët, me vetëm **31%** të respondentëve që kanë deklaruar që kujdesen për qentë në rrugë (Graf. 13). Mënyra kryesore e përkujdesjes ndaj qenve në rrugë është **ofrimi i ushqimit (61%)** dhe ujit (**33%**), **loja** dhe **dashuria (5%)** dhe **strehimi (1%)**.

Ndërsa përkujdesja ndaj qenve në rrugë përmes vaksinimit, pastrimit të parazitëve, kastrimit/sterilizimit apo mbrojtjes, nuk është prezente në komunën e Prishtinës (Graf. 14). Kjo shifër qartë tregon se numri i njerëzve (apo të quajtur edhe aktivistë të mbrojtjes së kafshëve endacake) është ende shumë i vogël.

KUJDESI NGA QYTETARËT PËR QENTË NË RRUGË




GRAF. 13. KUJDESI NGA QYTETARËT PËR QENTË NË RRUGË




GRAF. 14. LLOJI I KUJDESIT PËR QENTË NË RRUGË

2.3. Shqetësimet nga qentë në rrugë dhe keqtrajtimi apo frikësimi i tyre

Sa i përket shqetësimeve nga qentë endacak, **80% e respondentëve kanë deklaruar që janë shqetësuar nga qentë në rrugë në 12 muajt e fundit** (Graf. 15). Shqetësimet kryesore të qytetarëve që lidhen me qentë në rrugë, janë ndjekja e personave nga qentë (77%), të lehurat dhe kujtisjet e qenve (53%), shpërndarja e mbeturinave (29%), përlëshjet mes qenve (21%), kafshimet (11%) dhe dëmtimi i pronës (10%). **Ndërsa vetëm 2% e respondentëve kanë deklaruar që kanë pasur shqetësime që lidhen me mirëqenien dhe shëndetin e qenve në rrugë** (Graf. 16).




GRAF. 15. SHQETËSIMET NGA QENTË NË RRUGË NË MUAJIN E FUNDIT




GRAF. 16. LLOJET E SHQETËSIMEVE NGA QENTË NË RRUGË

Në lidhje me situatën e përgjithshme me qentë në rrugë, **84%** e qytetarëve mendojnë që numri i qenve në rrugë është i madh dhe shumë i madh (Graf. 17). Në pyetjen "A është problemi tek të gjithë qentë apo vetëm një/disa?", **52% e respondentëve kanë deklaruar që vetëm një ose disa qen në rrugë shkaktojnë probleme dhe shqetësime**, kurse **26%** mendojnë që problemi është tek të gjithë qentë në rrugë (Graf. 18).




GRAF. 17. NUMRI I QENVE NË RRUGË SIPAS RESPONDENTËVE



GRAF. 18. QENTË QË SHKAKTOJNË PROBLEME NË KOMUNITET SIPAS RESPONDENTËVE

Një tjetër objektivi i këtij projekti ka qenë edhe mbledhja e të dhënave për keqtrajtimin e qenve në rrugë nga njerëzit, si një komponent shumë i rëndësishëm i sjelljes së qenve ndaj njerëzve. Sipas WOAH¹⁸ dhe ICAM por edhe organizatave tjera ndërkombëtare, sjellja e qenve në rrugë në raport me njerëzit është e lidhur ngushtë me sjelljet e njerëzve ndaj këtyre qenve.

Në bazë të rezultateve të anketimit, **43%** e respondentëve kanë pohuar që kanë dëgjuar që në fshatin apo lagjen e tyre dikush ka keqtrajtuar, shqetësuar apo helmuar qentë në rrugë. Nga këto raste, **15% kanë qenë keqtrajtim kurse shqetësim dhe frikësim kanë qenë 27% të rasteve** (Graf. 19).




GRAF. 19. RESPONDENTËT QË KANË NJOHURI PËR KEQTRAJTIMIN APO NGACMIMIN E QENVE NË RRUGË

2.4. Zgjidhja për qentë në rrugë sipas qytetarëve


Sa i përket zgjidhjes së problemit me numrin e madh të qenve në rrugë, mbi **70%** të respondentëve kanë deklaruar që duhet të reduktohet numri i qenve në rrugë me metoda humane përmes masave si strehimi dhe kastrimi/sterilizimi. Vetëm **16%** të respondentëve kanë propozuar masa jo-humane siç është vrasja e qenve të rrugës (Graf. 20).

¹⁸<https://www.woah.org/en/home/>



GRAF.20. ZGJIDHJA PËR QENTË NË RRUGË SIPAS RESPONDENTËVE

Në lidhje me interesimin për adoptimin e qenve të rrugës (Graf. 21), **64%** e respondentëve kanë deklaruar që nuk janë të interesuar të mbajnë qen fare, kurse **21%** e respondentëve kanë deklaruar që do të adoptonin qen nga rruga (**6%**) apo nga strehimorja (**15%**).



GRAF.21. INTERESIMI PËR ADOPTIM

Në Komunën e Prishtinës, por as në ndonjë komunë tjetër në Kosovë, nuk ka ndonjë qendër të shpëtimit dhe strehimit, për të siguruar strehim gradual për qentë në rrugë dhe për të promovuar adoptimin e qenve që do të strehoheshin në ato qendra, në mënyrë që qëndrimi në qendër të jetë i përkohshëm. Ky aspekt është potencuar edhe në Strategjinë Kombëtare, ku ceket që ka mungesë të infrastrukturës për strehimin e qenve që potencialisht do të përfundonin të braktisur në rrugë, dhe që zhvillimi i infrastrukturës së qëndrueshme dhe humane të strehimit do të jetë i rëndësishëm për të mbështetur zbatimin e shërbimeve dhe programeve të MPQ-së vetëm nëse përcillet me masa të tjera që parashihen në këtë strategji dhe që synojnë të zvogëlojnë dhe kontrollojnë numrin e qenve endacak aktualisht në rrugë, sepse objektet duhet të përdoren vetëm për strehim të përkohshëm. Ndërtimi i strehimoreve tradicionale ku do të mblidheshin të gjithë qentë e rrugës apo një numër i madh i tyre, nuk është masë e qëndrueshme për menaxhimin dhe kontrollin e popullsisë së qenve dhe vetëm do të paraqiste probleme në funksionalitetin e mirëfillt të punës së strehimoreve.

Është e rëndësishme të theksohet se ka gjasa që trendi i marrjes së një qeni në familje të rritet në Kosovë, andaj prioritet të shtuar duhet t'i kushtohet promovimit të vazhdueshëm të adoptimit të qenve nga qendrat strehuese apo edhe direkt nga rruga, pasi që diku rreth 36% të njerëzve kanë treguar interesim për marrjen e një qeni në familjen e tyre (Graf. 21).

V.

KONKLUDIMET DHE REKOMANDIMET

Projekti **'Vlerësimi i dinamikës së popullsisë së qenve në komunën e Prishtinës'** është zbatuar duke përdorur 14 indikatorë (Kapitulli III) për të vlerësuar nivelin e problemit dhe burimet e këtij problemi. Përmes aktiviteteve të projektit, është synuar mbledhja e të dhënave mbi indikatorët, për të arritur deri tek një vlerësim profesional i situatës në terren. Mbledhja e të dhënave për qëllime të këtij projekti ka qenë e ndarë në dy faza: **1) anketimi i dinamikës së qenve në rrugë dhe 2) anketimi i amvisërive**. Faza e parë ka përfshirë vetëm zonën urbane të qytetit për të anketuar popullsinë e qenve, kurse faza e dytë e mbledhjes së të dhënave ka përfshirë zonat urbane dhe rurale.

Të dhënat nga terreni u mblodhën nga ekipe të përbëra nga studentë të veterinarisë dhe sociologjisë. Ekipi i FDK, me asistencën e profesorëve të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Dr. Bardhyl Noci dhe Dr. Driton Çausi, së bashku me ekspertin e analizimit të të dhënave MSc. Berat Abdiu, përgatiti dhe analizoi të dhënat. Kjo çoi me rezultatet e para të anketimit të dinamikës së popullsisë së qenve në Prishtinë.

Sipas **'Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin dhe Kontrollin e Qenve me dhe pa Pronar'** të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, anketimi i qenve në rrugë mund të kombinohet me anketimin e amvisërive për të treguar se cilët faktorë janë më të rëndësishëm në kontrollin e popullsisë së qenve, dhe për rrjedhojë llojin e masave që duhet të ndërmerren. Kjo mund të sugjerojë objektiva që duhet të vendosen për të vlerësuar progresin e masave të ndërmarra. Zonat me numrin ose dendësinë më të madhe të qenve në rrugë mund të zgjidhen si zona me prioritet; megjithatë faktorë të tjerë (p.sh. frekuenca e ankesave për qentë, ose problemet e mirëqenies të përjetuara nga qentë në zona të caktuara) mund të jenë gjithashtu të rëndësishëm për t'u konsideruar si prioritet.

Nga të gjeturat e vlerësimit të dinamikës së qenve në rrugë dhe nga matja e perceptimit të amvisërive në komunën e Prishtinës, për herë të parë në një komunë të Kosovës është pasqyruar situata faktike me qentë endacak dhe është vërtetuar se qentë në rrugë kanë burimin kryesor tek qentë me pronar.

Pothuajse **gjysma e respondentëve** që kanë deklaruar që mbajnë qen në shtëpitë e tyre kanë pohuar që qeni tyre i pa kastruar/sterilizuar, nuk kufizohet gjatë gjithë kohës brenda hapësirave të shtëpisë. Kjo do të thotë që *qentë e pa kastruar/sterilizuar me pronar, lejohen të bredhin edhe rrugëve (qoftë edhe nëse kjo ndodh rrallë), duke u riprodhuar me qentë e rrugës dhe duke rritur kështu edhe numrin e qenve në rrugë*. Edhe pse qentë krijojnë territorin e tyre ku kalojnë shumicën e kohës, gjatë ciklit të riprodhimit bredhin edhe jashtë territorit në kërkim të qenve të tjerë për t'u riprodhuar. Kjo është edhe një nga arsyet kryesore të humbjes së qenve.

Duke qenë se tashmë rishtas ka filluar projekti i **Identifikimit & Regjistrimit të qenve me pronar në gjithë Kosovën**, mund të thuhet që deri më tani *ende nuk ka kontroll shtetëror mbi qentë me mbajtës/pronar në Kosovë*, dhe tek pas **2-3 viteve** mund të vërehet rezultati i regjistrimit të qenve, *nëse po ashtu inspektimet veterinarë janë të rregullta* dhe aplikohen masat ndëshkimore për individët që braktisin qentë apo këlyshët në rrugë.

Të dhënat nga terreni janë mbledhur nga ekipet e përbëra nga studentë të veterinarisë dhe sociologjisë. Ekipi i FDK-së, me ndihmën e profesorëve nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Dr. Bardhyl Noci dhe Dr. Driton Çausi, së bashku me ekspertin për analizimi e të dhënave, MSc. Berat Abdiu, përgatitën dhe analizuan të dhënat. Kjo ka rezultuar me statistikat e para në lidhje me dinamikën e popullsisë së qenve në Prishtinë.

Indeksi i gjendjes së trupit të qenve tregon që *mirëqenia e qenve në rrugë në Prishtinë është e mirë*, me **mbi 80%** të qenve që *nuk kanë shenja të dukshme të problemeve me lëkurë apo probleme me peshë*. Vërehet po ashtu një trend i **kastrimit më të madh të qenve meshkuj** sesa i qenve femra, ndërsa **prania shumë e vogël e këlyshëve në rrugë apo qenve femra në laktacion** tregon që momentalisht *braktisja e qenve të rritur nga pronarët mbetet shkaku kryesor i shtimit të numrit të qenve në rrugë*.

Ndërkaq nga anketimi i amvisërive vërehet që ka një numër të konsiderueshëm të qenve me pronar që **nuk janë të kastruar/sterilizuar** dhe që **lejohen të bredhin jashtë hapësirave të shtëpisë (47%)**, duke rritur kështu gjasat për riprodhim me qentë aktual në rrugë, duke shtuar edhe më tej numrin e tyre. **Lindjet e padëshiruara të këlyshëve**, zakonisht përfundojnë me braktisjen e tyre, të cilët, në mungesë të kujdesit prindëror shumë të nevojshëm për javët e para të jetës së tyre, *gjasat për mbijetesë në rrugë apo për t'u shpëtuar i kanë shumë të vogla*.

Keqtrajtimi, shqetësimi dhe frikësimi i qenve në rrugë mbetet shqetësim për sigurinë e qenve dhe vet njerëzve, pasi që gjasat janë më të mëdha që qentë e keqtrajtuar nga njerëzit t'i shohin njerëzit si armiq dhe t'i sulmojnë për t'i "larguar nga territori". Një qasje paqësore nga njerëzit dhe *kujdesi për qentë është shumë i nevojshëm* për të parandaluar incidentet mes qenve dhe njerëzve. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që fushatat ndërgjegjësuese të organizohen në bazë të (mos) njohurive reale të qytetarëve dhe të fokusohen në temat kryesore që kontribuojnë në rritjen e vetëdijes shoqërore sa i përket mbajtjes së përgjegjshme të qenve dhe përkujdesjes së mirëfilltë ndaj tyre.

Sipas të gjeturave të këtij raporti, FDK rekomandon si në vijim:

► REKOMANDIM 1:

1.1. Projekti i KSVL-së duhet të zbatohet në vazhdimësi dhe të zgjerohet edhe në zonat rurale (fshatrat) të komunës së Prishtinës, për të parandaluar lindjen dhe migrimin e qenve në zonat urbane në kërkim të burimeve më të mëdha të ushqimit. KSVL po ashtu duhet të synojë të rrisë numrin e qenve të sterilizuar të gjinisë femërore, për të parandaluar lindjet e këlyshëve. Përqindja totale e kastrimit/sterilizimit duhet të synohet të jetë së paku 80%.

1.2. Rekomandohet që KSVL të fokusohet sa më parë në pjesën jugore të Prishtinës (Lagjja e Spitalit, Mati 1, Matiqan dhe Bregu i Diellit) dhe,

1.3. KSVL të fokusohet po ashtu edhe në pjesën lindore të Prishtinës (Sofali, Taslixhe, Parku i Gërmisë).

► REKOMANDIM 2:

Kastrimi/sterilizimi i qenve me mbajtës (pronar) duhet të promovohet nga ana e Komunës si një masë parandaluese e lindjeve të padëshiruara/paplanifikuara të këlyshëve. Të shikohet mundësia që varësisht nga kapacitetet financiare, ky shërbim të subvencionohet nga komuna e Prishtinës për një periudhë të caktuar, sidomos për amvisëritë në zonat rurale të komunës së Prishtinës.

► REKOMANDIM 3:

Të zbatohen dispozitat ligjore në fuqi për identifikimin dhe regjistrimin e qenve me pronar, përfshirë gjobot për braktisjen e tyre. Duhet të synohet identifikimi dhe regjistrimi i çdo qeni me mbajtës/pronar në komunën e Prishtinës.

► REKOMANDIM 4:

Të organizohen takime mes Komunës, Policisë së Kosovës dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, për të adresuar fenomenin negativ dhe jashtëligjor të braktisjeve të shumta të qenve në Prishtinë, që të ndërmerren masa më serioze dhe më intensive institucionale për të zbuluar dhe ndëshkuar braktisjet e shumta të qenve në Kryeqytet.

► REKOMANDIM 5:

5.1. Të organizohen fushata vetdijësuese (sidomos aktivitete informuese nepër lagje me komunitetin) në bashkëpunim me OJQ-të dhe akterë të tjerë relevantë. Fushatat ndërgjegjësuese duhet të fokusohen në promovimin e mbajtjes së përgjegjshme të qenve si kafshë shoqëruese, informimin e qytetarëve për sjelljet e qenve dhe natyrën e tyre (sidomos për qentë endacak), si dhe për përkujdesjen ndaj tyre si mënyra më e mirë e parandalimit të incidenteve në mes të njerëzve dhe qenve në rrugë.

5.2. Të organizohen sesione edukative për nxënësit dhe moshat e reja.

5.3. Të bëhet promovimi i vazhdueshëm i adoptimit të qenve;

► REKOMANDIM 6:

Duke marrë parasysh faktin se niveli i adoptimit të qenve në Komunën e Prishtinës është ende mjaft i ulët, nuk rekomandohet ndërtimi i strehimoreve me kapacitete të mëdha për strehimin e një numri të madh të qenve, por fokusi duhet të jetë në ndërtimin e qendrave shpëtuese të përkohshme, me kapacitete më të vogla dhe më lehtë të menaxhueshme për të promovuar dhe fasiluar adoptime të qenve që do të strehoheshin në ato qendra strehuese.

► REKOMANDIM 7:

Rekomandohet draftimi dhe aprovimi i një rregulloreje komunale që përcakton rregullat e mbajtjes së qenve në shtëpi, por edhe në hapësira publike. Rekomandohet që rregullorja të parasheh edhe vendosjen e një takse komunale për mbajtje të qenve, për të mbuluar shpenzimet e menaxhimit dhe kontrollit të popullsisë së qenve në komunën e Prishtinës.



Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga programi i **Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë'**, bashkëfinancuar nga **Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia**, dhe **Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut**.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e **Fondacionit për të Drejtat e Kafshëve** dhe *jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së, Suedisë apo Luksemburgut*.

REGJISTRIMI I QENVE ËSHTË

OBLIGIM
LIGJOR



DËRGOJE QENIN
TEK **VETERINARI**



REGJISTROJE QENIN
ME **MIKROÇIP**



MBAJE QENIN ME
PËRGJEGJËSI

ADOPTO, MOS BLET



© 2023 **Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve**
info@animalrights-rks.org
Rr. "Brahim Ademi", Mati 1, 10000 Prishtinë

